

Proces verbal

I mbledhjes së rradhës të Këshillit Bashkiak Kurbin 28.05.2025.

Mbajtur me datë 28 maj 2025 në sallën e mbledhjeve të Këshillit Bashkiak

Të pranishëm 25 këshilltarë

Kryetarja e Bashkisë, Zj. Majlinda Cara,

Drejtori I Ndhmës ekonomike, z. Ndoc Lleshi

Drejtori I Pyjeve z. Artan Miza

Edlira Lleshi, Kryetare e këshillit: Vazhdojmë me miratimin e rendit të ditës, ju lutem, a jeni dakord me rendin e ditës? Në rendin e ditës ka edhe tjetër. dhe të ndryshme, a jeni dakord me rendin e ditës, kush është pro? Atëherë, Arbër, para se të miratojmë, është dhe një projektvendim për shpalljen e datës 10 gusht si festa e qytetit të Laçit, a jeni dakord ta kalojmë tek të ndryshmet?

Miratohet Rendi i ditës: Vota pro 25, Vota Kundër 0 Abstenim 0.

Pika 1 e rendit të ditës

Edlira Lleshi, Kryetare e këshillit: Atëherë fillojmë, pika e parë, projektvendim për miratimin e ndihmës ekonomike 6% për muajin prill 2025. Drejtor, fjala për ju.

Llesh Ndoci, Drejtor I ndihmës ekonomike: Atëherë, projektvendimi fondit të kushtëzuar 6% për muajin prill 2015, nisur nga mbledhja e kaluar, kemi pasur një kërkesë të këshilltarëve për dy familje, që kanë aplikuar për arsye të parimit të përfundimit të vlefshmërisë dhe janë të përfshirë përsëri në skemën e 6%. Janë dy familjet që propozoi Deda muajin e kaluar, dy familjet që e ngrita për muajin e kaluar për përfshirje në sistem. Gjithsej janë përfshirë për muajin prill 133 familje në skemën e 6% me fondin 409626 lekë. Këto janë të detajuara, duke pasur parasysh edhe vendimin e këshillit të bashkisë miratuar në janarin e vitit të kaluar, janë 40 gra të veja, 36 janë të vetmuar, divorcuar 24, familje në nevojë 32 dhe një familje vajzë dhe një familje, gjithsej 130 familje. Bazuar në verifikimet dhe gjendjen sociale ekonomike për çdo familje, është bërë maksimumi për t'i përfshirë në skemën 6%. Ngel një pjesë e vogël familjesh që nuk fituan dhe pse janë në gjendje social-ekonomike të vështirë, për të cilat i kemi bërë kërkesë drejtorisë rajonale. Janë rreth katër-pesë familje, gra të veja me tre fëmijë e sipër, tre fëmijë e dy-tre fëmijë,

futen në sistem dhe na kanë premtuar që nga maji në vazhdim, sot në mëngjes ka dalë vendimi, e akoma se kemi zbardhur, do t'i përfshijmë në skemën e përfitimit të ndihmës ekonomike. Me informacionet tona bërë problem deri në ministri, gratë e veja me fëmijë, dy-tre fëmijë e sipër, parashikohet që sistemi i nxjerr fitues dhe na kanë marrë përsipër, sepse këtë radhë nuk janë përfshirë. Gjithsej 130 familje, emrat i kemi aty emër për emër, në qoftë se keni ndonjë vërejtje konkrete për familjet siç pati Deda për dy familje, i kam edhe këtu të shënuara: B.M., M.P. dhe një tjetër, tre familje, i kemi përfshirë në sistemin e 6%, sepse e meritojnë për t'u përfshirë. Mirëpo ligji edhe për 6% funksionon njëlloj si skema e përfituesit ekonomik në Tiranë. Minimalisht një herë në vit duhet të aplikojnë në sistem, se thashë ne kemi familje që e kuptojnë si rrogë bazë këtë 6% dhe duhet të dinë se ka zyrë pune, duhet të dinë se ka institucione të tjera dhe nuk duhet vetëm të presin para bashkisë e pyesin a kanë dalë lekë, kanë detyrime ligjore njëlloj si ato që përfitojnë dhe çdo ditë ne kontrollojmë skemën komplet. Kush nuk është paraqitur kurrë në Zyrën e Punës si i papunë jemi të detyruar ta nxjerrim prej skemës edhe pse kontrollit e nxjerr me ekonomi jo të mirë. Prandaj bëjmë zëvendësime të shpeshta që e shihni, heqim gjashtë, kthehen shtatë, heqim pesë, shtohen disa, sepse jemi të detyruar të bëjmë kontrollin sepse na quhet shkelje ligjore. Për çdo emër konkret që i shihni në mbarë lagjet apo njësitë që përfaqësoni, ju vetëm na i ngreni si emra, në moment I shikojmë dhe ato që janë për t'u përfshirë do përfshihen se s'bën. Sepse kemi këtu familje në nevojë, janë 38 familje dhe nga këto familje në nevojë nuk është e thënë që të futen patjetër në 6% para familjeve me gra të veja, të divorcuara apo vajza nëna edhe të vetmuara. Janë në të gjithë rrethin persona endacakë, kemi 20 ca persona pa nanë, pa babë, pa vëlla, pa motër, vetëm që interesohen, japim atë 6%. Jemi në dispozicion për çdo pyetje përgjigje.

Edlira Lleshi, Kryetare e këshillit: Pyetje? Po.

Anton Kolziu, këshilltar: Këto persona që janë larguar nga skema për riaplikim, janë njoftuar që u ka mbaruar afati?

Llesh Ndoci, Drejtor I ndihmës ekonomike Për emrin konkret?

Anton Kolziu, këshilltar: Personat që janë larguar nga skema, janë njoftuar për riaplikim prapë? Këtu te lista që futen në skemë, janë tre familje, një familje me 3 fëmijë, a jetohet me 4990 lekë, dhe a ka ndonjë formë tjetër që t'ju jepet ndihmë?

Llesh Ndoci, Drejtor I ndihmës ekonomike: Janë nëntë kriteret të përcaktuara për të përfituar ndihmën ekonomike, dhe gjithashtu një përqindje prej 6%, e cila është rregulluar me ligj. Kjo do të thotë se nuk mund të devijohet apo të veprohet sipas dëshirës, sepse çdo tejkalim është në shkelje të ligjit. Kur kam filluar punë këtu, ndihma ekonomike përfitohej nga rreth 140 mijë familje që kërkonin ndihmë ekonomike. Në një sistem ku nuk respektohen rregullat dhe ndihmat jepen sipas dëshirës, pa u përmbajtur dispozitave ligjore, nuk mund të flasim për drejtësi apo barazi. Ky është një problem serioz që nuk duhet toleruar.

Edlira Lleshi, Kryetare e këshillit: Pyetje tjetër? Zoti Pashk Prenga, të lutem.

Llesh Ndoci, Drejtor I ndihmës ekonomike: Edhe një sqarim të vogël për pytjen që më bëri kryetar i komisionit të ekonomisë, më lidhje me vendimin, kam marrë dhe vendimin me vete. Vendimi thotë që qytetari vjen dhe bën aplikimet nga data 1 deri në 10 pranë zyrave përkatëse me 12 deri në 15 shqyrtohen në sistemin qendror në Tiranë, në Ministrinë e Shëndetësisë. Unë kam qenë vetë atje thjesht për t'i parë për ankesa dhe probleme. 12 tavolina për 12 qarqe (prefektura) dhe shqyrtojnë aplikimet, i përpunojnë dhe ia dërgojnë për miratim përfundimisht i Drejtorisë Rajonale në Lezhë. Drejtoria Rajonale nxjerr vendimin dhe ia kalon direkt kryetares së bashkisë për të rakodruar me financën për të parë kush ka për të marrë lekë e të tjerat në vazhdimësi. Këtu ka një situatë të habitshme që ne s'kemi mundësi të japim përgjigje, pasi kemi dhe 100 e ca veta që nuk kanë marrë pikë të mjaftueshme, edhe pse me dy vetë me tre vetë me katër vetë deri në pesë veta ka raste që nuk kanë marrë pikë të mjaftueshme. Mirëpo në lidhje me këtë është vetë funksionimi i sistemit. Kemi kërkuar të na orientonin në seminare, në trajnime, në mbledhje me Drejtorëshën e përgjithshme, “Çfarë përgjigje ti japim qytetarit?” Qytetari vjen aty dhe thotë dua ndihmën s'du pike. Kjo është një skemë që aplikon sistemi deri më sot dhe vendimet janë me shkrim me firmë me vulë, si çdo shkresë ligjore. Qytetari vjen dhe ka aplikuar nuk ka marrë pikë të mjaftueshme, ka të drejtë aplikoj përsëri, një herë dy herë tre herë katër herë pesë herë në të kundërt në qoftë se qytetari nuk është dakort i bën një kërkesë me shkrim bashkisë Kurbin dhe i japim përgjigje me shkrim, bazuar në ligjin 57/2019, për aplikimin, datën, njësinë, menjëherë sa të marrë përgjigjen tonë me shkrim i drejtohet drejtorisë rajonale të Lezhës, pasi të marrim përgjigje nga Drejtoria e Lezhës që zbardh vendimin dhe bien vendimin këtu ka vetëm një drejtë: t'i drejtohet gjykatës. Gjykata vendos nëse i takon. Pasi të të dalë vendim i gjykatës është e padiskutueshme, që do të marri ndihmë, por kjo është rruga e ligjit, bashki, Drejtori Rajonale, gjykatë.

Edlira Lleshi, Kryetare e këshillit: Faleminderit! Pashk, të lutem pyetjen,

Pashk Prenga, Këshilltar: Në cilësinë e kryetarit të Komisionit të Ekonomisë, dua të theksoj se ne kemi shqyrtuar për herë të dytë materialin mbi skemën e ndihmës ekonomike dhe jemi sërish përballë të njëjtës situatë: qytetarit i vjen përgjigjja "nuk ke fituar pikët", pa asnjë sqarim konkret. Në radhë të parë, nuk ka arsye që një qytetar të vijë nga Mamurrasi, nga Fushë-Kuqja apo nga Miloti në Laç për të marrë një përgjigje që mund dhe duhet të jepet në nivelin e administratorit të njësisë. Administratori i ndihmës ekonomike, që e pranon aplikimin, duhet të jetë gjithashtu përgjegjës për t'i dhënë qytetarit një përgjigje të qartë dhe të argumentuar. Nuk është e pranueshme që qytetarët të sorollaten për një përgjigje që, në thelb, është thjesht: “nuk ke marrë pikët”.

Por, cilat janë këto pikë? Pse nuk e ka marrë qytetari ndihmën? Kjo duhet të shoqërohet me një sqarim të detajuar:

- Nuk je paraqitur në Zyrën e Punës;
- Ke një automjet në pronësi;
- Ke rezultuar i punësuar, por nuk e ke deklaruar;
- Të ardhurat familjare tejkalojnë kufirin e përcaktuar për përfitim nga ndihma ekonomike;
- Dokumentacioni i paraqitur është i paplotë ose i pasaktë.

Nuk po kërkojmë filozofi të madhe. Po kërkojmë thjesht që qytetarit t'i jepet një përgjigje konkrete, njerëzore dhe ligjërishit e justifikuar. Kjo është një kërkesë që e kemi ngritur edhe më parë, por fatkeqësisht nuk kemi parë reflektim. Nuk mund të pranojmë më që qytetari të sorollatet nga njëra zyrë në tjetrën, të bëjë kërkesë në këshill, pastaj të kthehet në zyrën e shërbimit social në Lezhë, e në fund t'i thuhet të ndjekë rrugën gjyqësore – kjo është një zvarritje absurde e procesit. Për mua, kjo nuk është logjike. Nuk është as funksionale dhe, mbi të gjitha, nuk është e drejtë, duke e ditur se shtresa që merr ndihmën ekonomike është shtresa më e varfër. Kjo është një kërkesë e përsëritur, dhe do të jetë e tillë sa herë që shohim që qytetari nuk merr përgjigje konkrete për një të drejtë kaq themelore.

Llesh Ndoci, Drejtor i ndihmës ekonomike: Të gjitha familjet që nuk përfitojnë ndihmë ekonomike, nuk e humbin atë për faj të qytetarëve, por për shkak të vendimmarrjes që vjen nga sistemi dhe strukturat përkatëse. Nga 1000 aplikues, shpesh ngelen jashtë 100 familje. Këto 100 raste janë në kompetencën e bashkisë, e administratorëve të njësive administrative dhe e zyrave të ndihmës ekonomike, për t'ia paraqitur këshillit për shqyrtim të mëtejshëm.

Shteti financon rreth **4.5 milionë lekë në muaj** për ndihmën ekonomike. Janë **rreth 60 milionë lekë në vit**, por shpesh këto fonde nuk përdoren plotësisht. Me të dhëna të vjetra, ndihma shpërndahet automatikisht nga sistemi përmes përzgjedhjes së pesë kritereve pilot. Sistemi thotë: "Këto janë familjet që përfitojnë", ndërsa për ato që nuk përfitojnë, është **këshilli** që duhet të ndërhyjë, të shqyrtojë dhe të ndajë fondin për ato raste që kanë mbetur jashtë për arsye jo të justifikuar.

Nga 100 familje që nuk përfitojnë automatikisht, 70 mund të përfitojnë përmes ndërhyrjes së këshillit. Por për këtë, njësitë vendore duhet të paraqesin informacionin e saktë dhe të plotë, të mbështetur me dokumentacion dhe verifikime konkrete.

Që nga **1 janari 2018**, sistemi funksionon tërësisht elektronikisht. Bashkia ka shpallur njoftime pranë të gjitha njësive administrative që qytetarët të aplikojnë për ndihmë ekonomike. Administratori i ndihmës ekonomike, sipas ligjit, është i detyruar të drejtojë 52 pyetje standarde qytetarit, lidhur me pronësinë, të ardhurat, mjetet, punësimin dhe përbërjen familjare. Të gjitha këto të dhëna hidhen menjëherë në sistem, të firmosura dhe të vulosura.

Brenda 30 ditëve, aplikimi duhet të shqyrtohet. Por këtu fillon problemi tjetër: nuk mjafton aplikimi, por **duhet bërë verifikimi në terren**, për të cilin ka përgjegjësi ligjore. Këto verifikime duhen mbështetur me **akt-shkresa dhe fotografi**, që më pas i dërgohen **Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale**.

Nëse në fund të vitit rezulton që ndihma ekonomike është dhënë pa verifikim real, rrezikohet ndëshkimi administrativ apo ligjor, sepse kemi raste ku një familje deklaron papunësi, por në verifikim del se zotëron tre makina dhe një vilë.

Prandaj, ne si këshill duhet të kërkojmë më shumë përgjegjësi, më shumë transparencë dhe më shumë mbështetje për ata që realisht kanë nevojë.

Edlira Lleshi, Kryetare e këshillit: O drejtor, ideja është që punonjësit e bashkisë duhet t'ua shpjegojnë qytetarëve në mënyrë të qartë dhe të kuptueshme se cilat janë kushtet që duhet të plotësohen për të përfituar ndihmën ekonomike. Duhet të jenë më të afërt, më të duruar dhe më të gatshëm për të dhënë informacion dhe orientim, sepse ka familje që nuk kanë mundësi ta kuptojnë vetë sistemin ose nuk kanë njohuri të mjaftueshme. Nevojitet më shumë fleksibilitet dhe angazhim nga ana e administratës vendore, për t'i qëndruar pranë qytetarit dhe për të shmangur burokracitë e panevojshme.

Edlira Lleshi, Kryetare e këshillit: Tashti është radha e Albertit, Albert a ke diçka për të thënë ?

Albert Ndoci, këshilltar: Po, janë bërë dy vjet që përsëritet e njëjta situatë. I hiqet ndihma ekonomike njërit, i jepet tjetrit. Është bërë problem i përhershëm. Unë mendoj se kjo zgjidhet shumë thjesht. Ne të gjithë bëjmë zhurmë, të gjithë flasim një për një, por zgjidhja është e qartë: të gjitha 61 bashkitë në Shqipëri të propozojnë atë që dikur propozoi Sali Berisha – minimumin jetik me ligj – dhe kështu mbyllet ky kalvar. Nuk ka më nevojë të luajmë me qytetarët – jo ia hoqën këtij, ia vunë atij. Jo! Kjo zgjidhet me ligj. Minimumi jetik garanton mbijetesën e qytetarëve, dhe mjafton të miratohet me ligj. Por, duket se nuk e duan, sepse duan ta mbajnë popullin në zvarrë si pulat.

Edlira Lleshi, Kryetare e këshillit: Faleminderit. Në rregull. Diskutim tjetër?

Ded Ndreca, Këshilltar: Në mbledhjen e kaluar ngrita një problem që lidhet me një familje në Mamurras. Edhe ju, z. Kryetar i Këshillit, së bashku me nënkryetarin e Bashkisë, u angazhuat për ta ndjekur çështjen. Por, që nga ajo ditë, deri më sot, nuk është marrë asnjë masë konkrete dhe nuk është kryer asnjë verifikim në terren.

Edlira Lleshi, Kryetare e këshillit: A nuk ishte një nga këto emrat që të tha, Lleshi?

Ded Ndreca, Këshilltar: Bëhet fjalë për një familje që, që nga ndërtimi i pallatit ku kanë jetuar, ka qenë në vështirësi të vazhdueshme. Aktualisht, ata jetojnë në kushte të rënda, në çadra apo në cepa pallatesh, duke vuajtur pasojat e disa fatkeqësive që kanë përjetuar. Objekti ku ndodhet kjo familje ndodhet tashmë në pronësi të Bashkisë.

Ju lutem që të merren masa për sistemimin e kësaj familjeje dhe për strehimin e tyre në një banesë të përshtatshme.

Edlira Lleshi, Kryetare e këshillit: Kryetare a je njoft me problemin?

Majlinda Cara, Kryetare e Bashkisë: Mirë, përshëndetje të gjithëve, të nderuar kryetarë, të nderuar këshilltarë. Unë jam e informuar edhe nga mbledhja tjetër e këshillit se është diskutuar për këtë familje por mendoj që duhet të ndjekim rendin e ditës. Nëse kemi të miratuar që të diskutojmë te pika 'Të ndryshme', atëherë do ta trajtojmë si rast atje.

Duke qenë se aktualisht jemi te çështja e ndihmës ekonomike, mendoj që duhet ta mbyllim këtë pikë më parë.”

Edlira Lleshi, Kryetare e Këshillit: Vazhdojmë. Dhe në fund, te ‘Të ndryshme’, do japim sqarimet. Në rregull, atëherë hedhim në votim ndihmën ekonomike. Kush është pro? Kundër?

Miratohet me dy vota kundër.

Projekt Vendimi për ndihmën ekonomike miratohet me Vota 23 pro, Vota kundër 2. Abstenime 0.

Pika 2 e rendit të ditës

Edlira Lleshi, Kryetare e Këshillit: Kalojmë tek pika e dytë të rendit të ditës: projektvendimi për miratimin e planit të masave për parandalimin dhe shuarjen e zjarreve në fondin pyjor-kullësor në Bashkinë Kurbin për vitin 2025.

Artan Miza, Drejtori i Pyjeve: Për parandalimin dhe shuarjen e zjarreve në fondin pyjor dhe kullësor të Bashkisë Kurbin për vitin 2025. Bashkia Kurbin, në kuadër të ushtrimit të funksionit të saj, ka në administrim edhe pyjet dhe kullotat vendore, sipas mënyrës së përcaktimit me ligj. Pjesë e kthimeve të administrimit të qëndrueshëm të fondit pyjor është edhe mbrojtja e pyjeve nga zjarri. Për këtë arsye, në zbatim të dispozitave ligjore, Bashkia Kurbin, nëpërmjet Agjencisë së Administrimit të Pyjeve dhe Kullotave, ka hartuar **planin e masave për parandalimin dhe shuarjen e zjarreve në fondin pyjor dhe kullësor për vitin 2025.**

Qëllimi i planit të masave për parandalimin dhe shuarjen e zjarreve në fondin pyjor dhe kullësor është ruajtja dhe mbrojtja e trashëgimisë pyjore nga zjarret. Siç përcaktohet në nenin 1 të ligjit të pyjeve, shprehet specifikisht: "mbrojtja e pyjeve si pasuri me rëndësi të veçantë për vlerat e mëdha dhe të pazëvendësueshme për mbrojtjen e klimës së tokës, ruajtjen dhe përmirësimin e potencialit prodhues të ekuilibrave të mjedisit natyror, biodiversitetit, burimeve gjenetike, regjimit hidrik si detyrim në interes kombëtar dhe ndërkombëtar".

Për të ndjekur këtë qëllim, strategjia e planit është zhvilluar në tre komponentë të konsoliduar dhe të përhapur në nivel kombëtar dhe europian: **parandalimi, parashikimi dhe lufta aktive kundër zjarreve në pyje**, së bashku me trajtimin dhe edukimin mjedisor.

Pavarësisht masave të ndërmarra përgjatë viteve, ende theksohet nga të gjithë aktorët që adresojnë mbrojtjen e pyjeve, duke u përmbledhur në një kërkesë të thjeshtë: "Pyllin vetëm mbroje, sepse rritet vetë." Plani parashikon masa që do të merren nga Bashkia Kurbin në bashkëpunim me institucione të tjera bashkëvepruese në parashikim, parandalim, luftim aktiv, trajtimin e personelit, por edhe më gjerë.

Ky plan masash është vjetor dhe është realizuar bazuar në një analizë të thellë të territorit. Janë analizuar zonat e territorit dhe periodha e vitit në të cilën ka më shumë të ngjarë të ndodhë zjarri, gjë e cila është thelbësore për të parandaluar fillimin ose përhapjen e tij.

Janë parashikuar masa për parandalimin e zjarreve. Parandalimi ka një kuptim të zgjeruar që shkon nga kujdesi për zonat e pyllëzuara, te kontrolli i përdoruesve të saj, si të zakonshëm ashtu edhe të rastit (p.sh. kalimtarë, turistë). Gjithashtu, vëmendje e veçantë i kushtohet zonave urbane, pyjore dhe bujqësore.

Për të parandaluar zjarret, të cilat varen pothuajse ekskluzivisht nga shkaqet njerëzore, nevojitet **ndërgjegjësim** që synon respektimin e pyllit, shmangien e qëndrimeve dhe veprimtarive të rrezikshme dhe bashkëpunimin aktiv në mbrojtjen e trashëgimisë pyjore.

Plani i masave për parandalimin dhe shuarjen e zjarreve në fondin pyjor të Bashkisë Kurbin për vitin 2025 përmban hapa dhe pika konkrete të cilat duhet të ndiqen në bashkëpunim me të gjitha institucionet:

1. Të bëhet një **trajnim me personelin** e bashkisë dhe të njësive administrative për t'i njohur me detyrat për mbrojtjen e pasurive pyjore, në bashkëpunim me Emergjencat Civile dhe Agjencinë e Administrimit të Pyjeve dhe Kullotave.
2. Të bëhet **inventarizimi i të gjitha mjeteve** që shërbejnë për fikjen e zjarreve; ato që kanë nevojë për kolaudim ose riparim, të vihen në efikasitet të plotë.
3. Agjencia e Administrimit të Pyjeve dhe njësiti administrative të rrethit, për çdo rast zjarri të konstatuar, të plotësojnë **dokumentacionin përkatës dhe të bëjnë kallëzim penal** pranë prokurorisë, referuar neneve përkatëse të Kodit Penal.
4. Nën kujdesin e Agjencisë së Administrimit të Pyjeve dhe Kullotave, kryetarët e fshatrave të hartojnë **listat e grupeve vullnetare të shuarjes së zjarreve**, të bazuara në lagje, me njerëz të përshtatshëm, në krye të të cilëve të jenë vetë kryetarët dhe personeli pyjor.
5. **Vrojtimi dhe sinjalizimi** të jetë prioritet i punës së personelit të njësive administrative dhe kryetarëve të fshatrave për të dhënë informacion të saktë dhe të shpejtë.
6. Secili kryetar fshati të studiojë **zonat e nxehta** të territorit të njësive administrative, të marrë kontakte të vazhdueshme me banorët dhe barinjët, si dhe të shkëmbejnë numrat e telefonave.
7. Në rast zjarri, **mjetet logjistike** (vegla pune: kazma, lopata etj.) të vihen në dispozicion të punonjësve që do të nisen për ndalimin, izolimin dhe fikjen, duke marrë secili nga një vegël pune.

Organizimi i sistemit të vrojtimeve dhe informacioneve është thelbësor, pasi ndërhyrja në kohë parandalon një shkatërrim masiv. Skema e lajmërimit është si më poshtë:

- **Vrojtuesit, inspektorët e pyjeve dhe kryetarët e fshatrave** (sipas listave të vullnetarëve për çdo fshat) njoftojnë kryetarët e njësive administrative.
- **Kryetarët e njësive administrative** njoftojnë menjëherë Kryetarin e Bashkisë dhe Policinë e Shtetit.
- **Kryetari i Bashkisë** njofton strukturat përkatëse si Sekretaria e Emergjencave Civile, Agjencia e Administrimit të Pyjeve dhe Drejtoria e Mekanizmit të Shuarjes së Zjarreve.

- Më pas, informacioni kalon te **Qendra Kombëtare e Operacioneve të Emergjencave Civile dhe Drejtoria e Mekanizmave për Shuarjen e Zjarrit.**

Për sa më sipër, bazuar në pikën katër, c të nenit 30 të Ligjit 57/2020 "Për Pyjet", kërkojmë që Këshilli Bashkiak Kurbin të miratojë **Planin e Masave për Parandalimin dhe Shuarjen e Zjarreve në Fondin Pyjor dhe Kullësor për vitin 2025**, sipas materialit të bashkangjitur.

Edlira Lleshi, Kryetare e këshillit: Po Anton, atëherë më fal Anton fjala për zotin Albert Ndoci .

Albert Ndoci, këshilltar: Ky plan masash që gjetëm në tavolinë është për 2025. Ky plan duhet të kishte ardhur në mars, dhe atëherë do të ishin realizuar këto takime. Ju, si drejtori apo si institucion, nuk i keni realizuar këto takime. Këto janë gjëra formale dhe nuk duhet të na bieni në këshill me to. E para, ne jemi me datë 28, jo me datë 15, 10, apo 5. Këto data që keni këtu nuk janë realizuar në terren. Asnjë procedurë nuk është realizuar në terren. Mund t'i pyesni edhe kryetarët e fshatrave. E dyta, sa punonjës keni në dispozicion si drejtori dhe sa prej tyre janë me profil pyjor, si teknikë apo inxhinierë? Po fondin për mirëmbajtjen e pyjeve sa e keni? Me sa di unë, vitin e kaluar është miratuar një shumë fondi për mirëmbajtjen e pyjeve.

Artan Miza, Drejtori i Pyjeve: Planet e masave për parandalimin e zjarreve u janë dërguar njësisë administrative, por takimet nuk janë realizuar në terren pasi ato varen nga krijimi i grupeve zjarrfikëse vullnetare. Aktualisht kemi në dispozicion nëntë punonjës: pesë inspektorë pyjesh dhe katër specialistë në zyrë, nga të cilët tre janë me profil pyjor.

Planet e menaxhimit hartohen për 10 vjet. Kur drejtoria e shërbimit pyjor u shkri dhe kaloi pranë Bashkisë Kurbin, të gjitha planet ekzistuese të menaxhimit u skaduan. Hartimi i një plani të ri menaxhimi kushton minimalisht 80 milionë lekë deri në 100 e sa milionë lekë. Fondi i Bashkisë nuk ka qenë i mjaftueshëm për të hartuar këto plane menaxhimi. Si pasojë, pa një plan menaxhimi efikas, nuk mund të bëhen propozime për investime në ministri, pasi ato nuk miratohen.

Anton Kolziu, këshilltar: Tani, në lidhje me rolin tuaj si drejtor apo përgjegjës, nuk e di saktësisht, por më duket se vitin e kaluar është miratuar një fond prej 60 milionë lekësh për mirëmbajtjen dhe mbjelljen e pyjeve të rinj. A janë realizuar këto punë? Zotëri, a keni pastruar pyje? Ku keni mbjellë pyje të reja? Në çfarë vendi keni mbjellë apo pastruar? Një ndër masat mbrojtëse nga zjarri është pikërisht pastrimi i pyjeve. A jeni marrë vetëm me shkresa për të marrë rrogën, a keni bërë propozime për gjëra konkrete? Dhe kullotat, zotëri, a përgjigjeni ju për pyjet në Kurbin? Ju duhet të merreni me punë!

Artan Miza, Drejtori i Pyjeve: Ne i kemi pasur të parashikuara në kuadër të masave. Ju thashë edhe një herë që ne nuk bëjmë dot propozime efikase për investime në pyje, sepse na mungojnë planet e menaxhimit. Kur të bëjmë një projekt për pyllëzim dhe ta dërgojmë, duhet ta dërgojmë në ministri dhe të marrim përgjigje e miratim.

Edlira Lleshi, Kryetare e këshillit: Ulu, ulu, zotëri. Ulu pak zoti Albert Ndoci., fjala për Kryetaren e Bashkisë.

Majlinda Cara, Kryetare e Bashkisë: I nderuar këshilltar, ju lutem, le të dëgjojmë njëri-tjetrin për të kuptuar pyetjet dhe për të kthyer përgjigjet e duhura. Ne jemi shumë të qartë dhe po i dëgjojmë me vëmendje të gjitha pyetjet tuaja. Nëse komunikojmë në këtë formë, ku ju bëni pyetje-përgjigje vetes dhe nuk na dëgjoni, nuk do ta çojmë dot në fund sqarimin, sidomos duke qenë se jemi drejtpërdrejt dhe duhet të sqarohemi edhe për publikun.

Përgjegjësi jua shpjegoi strukturën e punonjësve. Kemi mungesë të një drejtuesi aty për arsye të shkollimit. Thirrja për drejtues të mjedisit është hapur disa herë, por nuk është gjetur kandidat që të plotësojë të gjitha parametrat për të qenë drejtues i drejtorisë përkatëse.

Në këtë drejtori, me fondet e Bashkisë Kurbin, janë shtuar edhe punonjësit inspektorë të pyjeve, sepse më parë nuk kemi pasur të tillë. Kjo agjenci i është deleguar bashkisë dhe për këtë janë sjellë fonde vetëm për katër punonjës. Pjesa tjetër shtesë është bërë me buxhetin e bashkisë, për ta bërë zyrën sa më efikase.

Për të pasur investime në pyjet e territorit që ne mbulojmë, duhet patjetër të kemi planin e menaxhimit të pyjeve dhe planin e mbështetjes së pyjeve. Nëse nuk kemi planin e mbështetjes së pyjeve, nuk mund të ndërhyjmë as për pyllëzim, as për shpyllëzim.

Plani i menaxhimit bëhet ose me procedurë prokurimi, ku studio që merren me këtë punë futen dhe hartojnë këtë plan, ose me donatorë. Kërkesën për donatorë nga jashtë e kemi bërë disa herë për të ndihmuar në hartimin e planit të pyjeve.

Në momentin që bashkia do të hartojë këtë plan menaxhimi, patjetër do të hyhet me projekte konkrete në pyje, qoftë për pyllëzim, prerje, dhënie në përdorim apo dhënie me qira. Kemi pasur kërkesa të shumta nga qytetarët tanë për marrjen e kullotave me qira, por nuk mund t'i japim dot pa pasur planin e menaxhimit të pyjeve.

Këtë vit, siç e keni parë edhe në buxhet, kemi lënë një buxhet për hartimin e parë të një plani menaxhimi të pyjeve. Aktualisht jemi në procedura projektimi për të vazhduar më tej. Në momentin që do të bëhet ky plan, i cili është për fazën e parë të pyjeve, ne do të fillojmë dhe të bëjmë të gjithë procedurën ligjore, siç e përcakton ligji për pyjet, për dhënien e kullotave apo edhe për bashkimin e pyjeve dhe rikuperimin e tyre.

E para është, i nderuar këshilltar, e para është hartimi i planit të menaxhimit të pyjeve, mbështetja e pyjeve. Në momentin që hartohet ky plan, ndërhyhet me fazat e tjera në çdo hartë kadastrale.

Anton Kolziu, këshilltar: Zonja kryetare, ta kam bërë një vërejtje privatisht. Në qoftë se drejtorët ose përgjegjësit e zyrave nuk janë të aftë për të justifikuar vendin e punës ku janë, nuk

është pse t'ju dalësh mbrojtje. Po patjetër është kryetari bashkisë, po në qoftë se nuk janë të zota do për të dhënë përgjigje atëherë më mirë të kërkojmë detaje

Marjana Gjini, këshilltare: Meqë jemi te diskutimi për pyjet, kam një sugjerim. Nuk e di sa i realizueshëm mund të jetë, por për pyllin e djegur, atë që përbën kurorën e qytetit, duhet bërë një pastrim. Kjo nënkupton prerjen e drurëve të djegur. Ndoshta mund të krijohet një fond i veçantë apo të kalojë një fond specifik për këtë qëllim. Duhet të ketë një plan të veçantë për këtë ndërhyrje.

Majlinda Cara, Kryetare e Bashkisë: E nderuar këshilltare! Siç e sqarova më parë, nëse nuk kemi një plan të hartuar të menaxhimit të pyjeve, nuk mund të ndërhyjmë në këto zona. Ekziston një procedurë e saktë ligjore se si duhet ndërhyrë në pyje. Nuk mund të veprojmë vetëm sepse dëshiron kryetari i bashkisë, komuniteti, këshilltarët, apo ne të gjithë bashkë. Plani i menaxhimit të pyjeve hartohet sipas një procedure kohore. Edhe për pyllëzimin e zonave të djegura, nuk mund të ndërhyjmë menjëherë pas zjarrit. Ka një afat kohor për të pritur, pasi pylli mund të rikuperohet natyrshëm. Pasi të hartohet plani i menaxhimit, ne jemi të detyruar të ndërhyjmë sipas atij plani edhe në pjesët e prekura nga djegiet.

Albert Ndoci, këshilltar: A ka nevojë për plan menaxhimi ruajtja dhe administrimi i pyjeve? Pyetja ime është për ruajtjen dhe administrimin, jo për investimet. Më bëni të ruaj 20 km rrugë, ndërkohë që keni shkatërruar 2 km dhe një shesh përballë qendrës historike të Kurbinin. Kurbinin identifikohet me Sebastianin. Aty keni një rrugë 2 km, një pistë 2 km, e matur edhe me Google dhe të gjitha mjetet e tjera. Do t'i vijë koha asaj pune kur ta shoh, dhe nuk kishte nevojë fare për plan menaxhimi për të shkatërruar pyjet, për të hapur rrugë pa leje, për të hapur pista dhe sheshe.

Nuk ka nevojë as për plan menaxhimi për të prerë pishat aty, siç i kanë prerë krejt katunarët në mënyrë të paligjshme. Në orën 12 të ditës ose në 12 të natës, i ke këto pisha, për të cilat ju kam thënë para një viti që kanë nevojë. Ato pisha thjesht duhet të priten. E di shumë mirë që me një mandat do t'i keni bërë dru të thata, s'keni ku t'i bëni. Merrni nja 2 metra dru të thata aty dhe bëni evadimin, por nuk e doni. Ju i shihni pyjet si armiq, si përfitim. I shihni si armiq dhe thoni mbrapa "turizmi, turizmi", pa këtë mushkëri që janë rreth 9000 hektarë. Tani është profesionist i pyjeve. E keni marrë me vonesë, por unë nuk them që s'keni goditur. Sa ka rreth vetes? Asnjë? Nuk kemi pasur specialist pyjesh, inxhinier pyjesh. Por ju doni njerëz të partisë suaj – patronazhistë komunistë, socialistë, socialdemokratë. Nuk doni ata që bëjnë punën. Po të donit ata që bëjnë punën, puna bëhet në një sekondë, si të doni ju.

Majlinda Cara, Kryetare e Bashkisë: Faleminderit tani i nderuar këshilltar nëse nëse ju doni të dilni dhe të sipas dëshirës tuaj aty, jo, të lutem, të lutem. Duhet të më dëgjosh, sepse të dëgjuam. E nderuar kryetare, nëse këshilltarët duhet ta bëjnë pyetje-përgjigje me veten, ju lutem, mund të na thoni ne si administratë, patjetër, të lutem shumë...

Edlira Lleshi, Kryetare e këshillit: I nderuar këshilltar, duhet të keni respekt! Të paktën edukatën, të dëgjoni kryetaren e bashkisë. Kryetari i bashkisë merr fjalën sa herë është e nevojshme për të sqaruar. Faleminderit! Jo, nuk është me ja fut kot ku të duash ti. Ideja është, do

flasim sipas rendit të ditës, do bëjmë pyetje, diskutime, sipas rendit, sipas ligjit, sipas edukatës qytetare.

Majlinda Cara, Kryetare e Bashkisë: Nëse doni të flisni dhe të hidhni pretendime të pabazuara, dhe nuk lejoni as të dëgjohet fjala, unë këtë nuk e kuptoj dot. I nderuar këshilltar, po të drejtohem edhe një herë këtu në Këshillin Bashkiak: të lutem, të dëgjojmë njëri-tjetrin!

Artan Miza, Drejtori i Pyjeve: Për rastin konkret, për rrugën e hapur, është bërë kallëzim penal në prokurori dhe janë marrë masat përkatëse.

Aida Skeja, Këshilltare: E nderuar kryetare e bashkisë, kryetar i këshillit, të nderuar anëtarë të Këshillit Bashkiak. Unë kam vetëm dy pyetje në lidhje me miratimin e planit të masave për parandalimin dhe shuarjen e zjarreve. Pyetja e parë lidhet me dokumentet që kemi marrë sot. Këtu shënon me datë 19/5/2025. Zoti drejtor, ka ndonjë arsye pse e marrim këtë dokument vetëm 10 minuta para se të fillojmë mbledhjen (erdha pak me vonesë për shkak të orarit mësimor)? Pse nuk na është sjellë bashkë me dokumentet e tjera që kemi marrë para pesë ditësh? Faleminderit.

Pyetja e dytë lidhet me mënyrën se si janë trajtuar problemet, siç është struktura e ngarkuar, vendi dhe afati. Por, më e rëndësishmja, për qytetarët – jo për ne, sepse ne ndoshta i mbajmë mend ose jo – qytetarët nuk e dinë sa mjete shërbejnë për fikjen e zjarreve. Këtu keni përcaktuar afat muajin prill. Sa mjete janë të shuarjes së zjarreve dhe kur ka ndodhur koordinimi i tyre? A ka ndodhur fare? Sa mjete janë në dispozicion për qytetarët?

Artan Miza, Drejtori i Pyjeve: Faleminderit! Së pari, lidhur me pyetjen tuaj për dokumentacionin dhe afatet: Plani i masave parandaluese për zjarret fillon me kërkesat e Këshillit të Qarkut dhe Prefekturës për informacione të vazhdueshme. Unë prisja ngritjen e grupeve të zjarrfikësve sipas njësive administrative, të cilat ua kam dërguar administratorëve, sepse pikërisht aty fillon puna. Pas krijimit të këtyre grupeve do të nisim takimet me të gjitha skuadrat zjarrfikëse. Lidhur me pyetjen tuaj të dytë për mjetet: Po, do të ishte normale të jepnim informacionin e saktë. Agjencia e Administrimit të Pyjeve ka në dispozicion dy mjete për shuarjen e zjarreve në rang bashkie, të cilat janë në gatishmëri. Megjithatë, duhet theksuar se është e angazhuar edhe Drejtoria e Mekanizmit të Shuarjes së Zjarreve. Prandaj, ky plan masash është hartuar në bashkëpunim me të gjitha strukturat përkatëse.

Aida Skeja, Këshilltare: "Faleminderit, ndoshta do të ishte më edhe për edhe për qytetarët, të jenë në dijeni, për shembull sa mjete janë, edhe për po të më pyesnin mua sa mjete ka bashkia kur bëjnë për shuarjen e zjarreve, unë ju them jam tre, janë dy, janë një, janë pesë, faleminderit,

Majlinda Cara, Kryetare e Bashkisë: Po mund ta sqaroj unë këshilltaren. E nderuar, janë dy mjete zjarrfikëse për shuarjen e zjarrit në dispozicion të Bashkisë Kurbin. Drejtoria e Pyjeve nuk ka mjete për shuarjen e zjarrit; ata kanë vetëm vrojtuesit dhe inspektorët, si dhe mjetet e administratës që vëzhgojnë pyjet. Këto dy mjete të bashkisë janë aktualisht në gjendje pune, të kolauduara dhe të restauruara, dhe janë në gatishmëri të plotë për çdo fatkeqësi në pyje, banesa, apo kudo tjetër. Gjithashtu, nga Ministria e Mbrojtjes, nëpërmjet Emergjencave Civile, i është

rialokuar edhe një fond për blerjen e një mjete të ri zjarrfikës për Bashkinë Kurbin këtë vit. Pavarësisht inspektimeve apo kapaciteteve të bashkisë, shuarja e zjarrit kërkon koordinim. Ne, në koordinim me prefektin e Qarkut Lezhë, koordinojmë të tre bashkitë e qarkut. Nëse situata i kalon kapacitetet edhe të bashkive të qarkut, ne kërkojmë ndihmën e Emergjencave Civile Kombëtare. Kështu, i gjithë ekipi i Emergjencave Civile të bashkisë, i gjithë qarku dhe i gjithë Shqipëria janë në gatishmëri për të marrë masa të menjëhershme për shuarjen ose vënien në dispozicion të ndihmës për qytetarët, pyjet dhe kullotat që mund të preken. Shpresojmë që këtë vit të mos kemi raste të tilla, por ne jemi në gatishmëri për çdo situatë që mund të krijohet në territorin e Bashkisë Kurbin. Patjetër që me dy mjete nuk mund të përballohet situata. Megjithatë, falë ndihmës së Emergjencave Civile, prefektit të qarkut dhe bashkive me të cilat koordinojmë, kemi arritur të mos kemi probleme shumë të mëdha në territorin tonë vitet e kaluara. Pjesën më të madhe të situatave i kemi parandaluar me mjetet dhe shtabet tona të Emergjencave Civile. Në shtabet e Emergjencave Civile, përveç Bashkisë Kurbin, janë përfshirë të gjitha institucionet që operojnë në zonë: Policia e Shtetit, spitali, NVKS-ja, elektrik, ujësjellësi, kanalizimet, e të gjitha institucionet e tjera. Të gjitha këto janë pjesë e shtabit të emergjencës dhe janë në gatishmëri numër një për çdo rast nevojë.

Edlira Lleshi, Kryetare e këshillit: - Faleminderit përsëri kryetare. Rinaldo!

Rinaldo Piroli, këshilltar: Përsëritje të gjithëve! Zoti drejtor, ka kohë që materialet na vijnë blazë. E kemi ngritur disa herë këtë shqetësim, dhe nuk e kam me ty personalisht, pasi nuk janë vetëm këto. Megjithatë, duke qenë se jemi te rasti yt, si mund ta miratojmë këtë? Ne kemi kaluar muajin prill dhe datën 10 maj. Si mund t'i rikthejmë ne këto data, si mund të na kërkosh ta miratojmë këtë plan, kur prilli dhe data 10 maj kanë kaluar?

Artan Miza, Drejtori i Pyjeve: Prefekti vetë është pjesë e Shtabit të Emergjencave Civile, si përfaqësues në rang qarku dhe kombëtar. Shkresa ka ardhur në fund të muajit mars. Ne kemi bërë dokumentacionin brenda gjashtë ditësh dhe e kemi dërguar njësitë administrative për krijimin e skuadrave zjarrfikëse. Pasi t'i miratojmë skuadrat, do t'i dërgojmë sërish në Prefekturë.

Ne jemi në kohë me krijimin e skuadrave zjarrfikëse. Do të bëjmë takimet nëpër njësitë administrative, të cilat nuk i bëjmë vetëm për zjarret, por edhe për probleme të tjera me kryetarët e fshatrave.

Rinaldo Piroli, këshilltar: Si do të veprohet me punët dhe projektet që ishin parashikuar të trajtoheshin në prill? Si do t'i rikthejmë ne ato projekte dhe problemet që duhej të ishin trajtuar gjatë muajit prill?

Artan Miza, Drejtori i Pyjeve: Muajt maj, prill e mars nuk janë vera e vërtetë për zjarret. Ne i mbarojmë këto brenda muajit. Korriku dhe gushti janë dy muajt më kryesorë për zjarret në pyje. Kështu që, ne jemi në kohë. Faleminderit!

Edlira Lleshi, Kryetare e këshillit: Po, faleminderit. A ka pyetje apo diskutime të tjera? E hedhim në votim. Kush është pro? (Arbër, i numërovet?) Kush është kundër? Abstenim? Me një abstenim, miratohet.

Projekt Vendimi për Për parandalimin dhe shuarjen e zjarreve në fondin pyjor dhe kullësor të Bashkisë Kurbin miratohet me 17(shtatëmbëdhjet) vota pro , Vota Kundër 7(shtatë), Abstenim 1(një) vote.

Pika “të ndryshme” e rendit të ditës

Edlira Lleshi, Kryetare e këshillit: Tani kalojmë tek pika “Të ndryshme”. Kemi projektvendimin për shpalljen e datës 10 gusht si Festa e Qytetit. Këtë e kemi diskutuar, kështu që nuk besoj se kemi nevojë për diskutim të mëtejshëm.

E hedhim në votim. Kush është pro? Kundër?Miratohet.

Projekt Vendimi për “Për shpalljen e datës 10 gusht si Festa e Qytetit” miratohet me vota pro 25, Vota Kundër 0 zero , Abstenim 0 zero.

Edlira Lleshi, Kryetare e këshillit: Unë kaq kisha sot, mund ta mbyllim mbledhjen. Domethënë tek të ndryshmet s'kemi miratuar gjë përveç

Diskutime

Majlinda Cara, Kryetare e Bashkisë: E nderuar kryetare! Të lutem, nga mbledhja e kaluar patëm dy kërkesa nga këshilli bashkiak dhe meqënëse kryetari bashkisë nuk ishte, më lejo që t'i relatoj atë sa duhet të japim një informacion.

Albert Ndoci, këshilltar: Tani, kryetari, ne patëm këtu herën tjetër... po, drejtorin. Drejtori është... nuk e di ai i inspektoriatit, ai i menaxhimit, nuk e dimë, por mjafton që ky i përfaqëson më mirë se sa ata, sepse ata s'marrin vesh nga pyjet. Po edhe drejtorin e rrugëve rurale e kemi pasftuar, por ju nuk u paraqitët aty, domethënë janë të ftuar. Po drejtorin e rrugëve rurale e kemi pasftuar, besoj e kemi mirë. Nuk e di se se kemi parë ndonjëherë.

Majlinda Cara, Kryetare e Bashkisë: E nderuar kryetare, ju lutem! Kur kryetari i bashkisë merr fjalën për të relacionuar mbi kërkesat që Këshilli Bashkiak ka bërë në një mbledhje të mëparshme dhe i është drejtuar atij, unë nuk e toleroj më këtë ndërhyrje ku flasin këshilltarë dhe mendojnë sipas dëshirave të tyre. Ju lutem, kryetare, kryetari i bashkisë ka të drejtë të marrë fjalën sa herë është e nevojshme. E bëj të qartë, kjo është edhe për sqarim të qytetarëve, sepse jemi në komunikim të drejtpërdrejtë me ta. Nëse çdo këshilltar ngrihet dhe flet sipas interesave të

tij personalë, unë e kam të pamundur të përgjigjem. Ka një rend dite dhe një kërkesë që depozitohet pranë sekretarisë së Këshillit Bashkiak. Për dy çështje janë depozituar kërkesa në sekretarinë e Këshillit Bashkiak dhe është vënë në dijeni kryetari i bashkisë. Për këtë arsye jam sot në mbledhjen e këshillit, për t'jua bërë të qartë këshilltarëve dhe qytetarëve.

Një nga pikat ka qenë për zonën Njësh-Nish, lagjen e rindërtuar nga qeveria turke, ku jemi me procesin e certifikimit. Në zonën Njësh, është ndjekur e gjithë procedura ligjore lidhur me pajisjen me dokumentacionin e duhur për rindërtimin e saj, duke nisur nga lejet e shembjes, pajisja me plan të detyruar vendor, leja e ndërtimit, ndryshimet në projekte gjatë zbatimit të punimeve, si dhe certifikata e përdorimit.

I gjithë ky dokumentacion është depozituar fizikisht nga Bashkia Kurbin në Agjencinë Shtetërore të Kadastrës Kurbin. Gjithashtu, është kryer edhe aplikimi në sistem për regjistrimin e këtyre objekteve dhe për pajisjen me certifikatat e reja të pronësisë.

Në këtë moment, nuk është më në kompetencë të Bashkisë Kurbin. Sqaroj këshilltarët, por edhe qytetarët e interesuar, pasi edhe me qytetarët janë bërë dëgjesa dhe është komunikuar. Bashkia Kurbin ka kryer të gjithë procedurën ligjore të inventarizimit të objekteve për dërgimin në Agjencinë Shtetërore të Kadastrës. Tashmë jemi në pritje nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës për nxjerrjen e certifikimit të të gjitha objekteve të zonës Njësh. Ashtu siç qytetarët takojnë ju, ne jemi çdo ditë me ta dhe jemi të interesuar që kjo procedurë të mbyllet sa më shpejt dhe mirë. Kjo ka procedura ligjore për t'u mbyllur, duke nisur nga dalja e certifikatës, sepse i gjithë objekti, të gjitha hyrjet, certifikohen fillimisht në emër të Bashkisë Kurbin. Më pas, ligji për aktin normativ numër nëntë për tërmetin e ka të qartë se si kalohet certifikata nga Bashkia Kurbin tek qytetari.

Kjo ka kohën e nevojshme. Ashtu siç jemi ne të interesuar për qytetarët, edhe këshilltarët i falënderoj që interesohen çdo ditë për ta. Por duhet të dinë që nuk është një ngërç nga bashkia pse nuk jepen certifikatat. Ne presim certifikimin nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës për të gjitha objektet, procedurë e cila, nga informacioni që kemi, ka filluar. Ky është sqarimi i parë.

Ndërsa sqarimi për atë që i nderuari këshilltar, zoti Bert Ndoci, bën çdo ditë në mbledhjen e këshillit, në dy mbledhje radhazi, që unë nuk e...

Për sa i përket informacionit që kemi kërkuar për një hapje rruge, nga Bashkia Kurbin është ndjekur e gjithë procedura ligjore që në momentet e para. Inspektoriati i Pyjeve dhe Inspektoriati i Mbrojtjes së Territorit kanë vepruar shpejt. Kryetari i Bashkisë dhe Inspektoriati kanë bërë kallëzim penal në Prokurorinë e Lezhës që në momentin e parë të identifikimit. Tani jemi në pritje të vendimit të organeve kompetente se si do të shprehen për këtë rast. Nuk mundet asnjë këshilltar të drejtohet në këtë mënyrë pa marrë informacionin e duhur, të cilin mund ta merrte fare mirë në bashki, dhe të hedhë baltë mbi administratën apo kryetarin e Bashkisë.

Bazuar në informacionin ligjor, që në momentin që Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit dhe inspektorët e pyjeve kanë konstatuar rastin, Bashkia Kurbin ka ndjekur të gjithë procedurën

ligjore deri në kallëzimin penal. Nëse një këshilltar kërkon t'i vihet në dispozicion procedura, është i lutur të depozitojë kërkesën dhe ajo do t'i vihet në dispozicion. Organet kompetente kanë vazhduar hetimin. Janë thirrur personat në dijeni, si dhe personat që kanë mbajtur procedurën. Ia lëmë organeve kompetente zgjidhjen e çështjes dhe përcaktimin e përgjegjësisë për dëmtimin e pjesës që këshilltari ka kërkuar në mbledhjen e radhës. Faleminderit!

Sefedin Lika, këshilltar: Faleminderit! Unë kisha një kërkesë. Herën e kaluar, diskutova për fshatin Shullaz, dhe folëm katër veta gjithsej. Ju thatë se përgjigjen do ta jepnit me shkrim. Tani, sekretari ka të drejtë të dëgjojë, të shkruajë dhe të na kthejë përgjigjen me shkrim. Mua ma ktheve me gojë. Tani, të lutem, ma kthe përgjigjen me shkrim, në mënyrë që t'ua çoj banorëve atje. Nuk jemi këtu për të bërë replika me njëri-tjetrin.

Edlira Lleshi, Kryetare e këshillit: Në rregull. Në rregull. Tjetër? Po, dhe Aida është e fundit.

Aida Skeja, Këshilltare: Besoj që kjo është pyetja e fundit. Doja të dija nëse ka ndonjë afat ose informacion se kur do të hapen dy qendrat shëndetësore? Njëra është ajo e Fushë-Milotit, e cila më duket se ka përfunduar prej më shumë se një viti, dhe tjetra ajo e Sanxhakut. Kjo është një kërkesë nga qytetarët. Ka ndonjë afat se kur do të jenë këto dy qendra në shërbim të qytetarëve? Faleminderit! (Po, ajo e Fushë-Milotit dhe e Sanxhakut). Faleminderit!

Edlira Lleshi, Kryetare e këshillit: - kryetare a mund të japësh një përgjigje apo ta depozitojmë

Majlinda Cara, Kryetare e Bashkisë: Patjetër! Bashkia Kurbin ka pasur si objektiv rikonstrukcionin apo ndërtimin nga e para të pesë qendrave shëndetësore: Qendra Shëndetësore Laç, Mamurras, Sanxhak, Fushë-Milot dhe Gjorm. Qendrat shëndetësore të Laçit dhe Mamurrasit tashmë janë hapur. Ndërsa për qendrat shëndetësore të Sanxhakut, Gjormit dhe Fushë-Milotit, arsyeja pse nuk janë hapur ende është se objekti i ndërtimit nuk përfshinte mobilimin. Mobilimi është kompetencë e Ministrisë së Shëndetësisë. Jemi në komunikim me drejtorinë e lartë të NVKS-së (Ndërmarrja e Veprave Komunale dhe Shërbimeve) dhe procedura është kryer. Priten pajisjet e reja për të bërë hapjen edhe të këtyre tre qendrave. Pra, puna e ndërtimit nga ana e bashkisë ka përfunduar, dhe ne jemi vetëm në fazën e pritjes për ti hapur.

Edlira Lleshi, Kryetare e këshillit: Deklaroj Mbylljen e mbledhjes Laç 28.05.2025.

Sekretari i Këshillit

Arber LEKA